

KËRKESË
Nr. 97/5, datë 3.2.2023

PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR SHKËMBIMIN E PRONËS,
PËR INTERES PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësim dhe/ose shkëmbim të pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, Bashkia Durrës – “Rikonstruksioni i rrugëve ‘Miqësia’ dhe ‘Azem Hajdari’, loti II – rruga ‘Miqësia’”.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

1. Për pasurinë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

2. Vlerësimi për pasurinë e llojit “arë”, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në shkresën e ASHK-së Durrës nr. 6411/1 prot., datë 13.9.2022.

3. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, me funksion jobanimi, është bërë sipas VKM nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në çmimin sipas UKM nr. 3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”;

4. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, me funksion banimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në çmimin mesatar të shitblerjeve, të 3(tre) muajve të fundit, konfirmuar nga ASHK-ja Durrës me shkresën nr. 6187/1 prot., datë 9.9.2022.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Durrës, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi prej 28,055,400 (njëzet e tetë milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekësh.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT DHE/OSE SHKËMBIMIT
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA PROCESI I RINDERTIMIT NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM NË SPITALLË,
BASHKIA DURRËS – “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE ‘MIQËSIA’ DHE ‘AZEM HAJDARI’, LOTI II – RRUGA ‘MIQËSIA’”

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]